

FJALA E DEPUTETES MERITA BAKIU

E MARTË 1 NËNTOR 2022

Zonja kryetare, unë e shikoj që anëtarët e pozitës janë shumë të shqetësuar.

Zoti Koçi, me gjithë respektin që kam për mënyrën se si e drejtoni komisionin sa herë jeni në drejtim të komisionit, por edhe ju vetë e kuptoni që nuk është korrekte që drejtori nuk është vetë prezent. Dy të pranishmit mund ta shoqëronin drejtorin, sepse ishte në respektin e këtij komisioni që ai të ishte i pranishëm. Ne nuk duam të ofendojmë pjesëmarrjen e të ftuarve, por që gjëja të ishte më korrekt, drejtori duhet të ishte vetë prezent. Ju e dini që ajo pjesë nuk është korrekte dhe po e mbron.

Ne mund ta vazhdojmë dëgjuesën, sepse i sollët të pranishmit këtu, prishët edhe komisionet e tjera dhe i sollët kolegët, por gjërat duhet të jenë korrekte. Do të ishte në dinjitetin e këtij komisioni që drejtori të vinte në komision, sepse është Komisioni i Medies. Është duke bërë propagandën tuaj, zotëri. Faleminderit, kryetare!